



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primito Mirëdana ... 19.12.2012 ... vit/god.			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-	013	1461	



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 82.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/1008, Rekomandimit të MAPL-së dhe nenit 36.2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 14 dhjetor 2012 aprovon këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT PËR BARTJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË PALUAJTSHMËRISË (TOKË) NË PRONËSI SHOQËRORE PRONË E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË NË SHFRYTËZUESIN E PËRKOHËSHËM FATIME RAMADANI

Neni 1

Me këtë vendimi, Kuvendi i Komunës së Vitisë **SHFUQIZON** Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë (tokës) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës, dhe rrjedh si pasoj e pengesave ligjore, sepse me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale duhet të zbatohen kriteret e përcaktuara me Ligjin për Prokurim, neni 5 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr 03/L-226, si dhe Udhëzimi Administrativ nr 2012/02 për zbatimin e Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

Neni 3

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, **shfuqizohen** të gjitha pasojat juridike të cilat janë prodhuar me Vendimin për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pa luajtshmërisë (tokës) në pronësi shoqërore pronë e Kuvendit të Komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Fatime Ramadani me nr 01-013/141 të datës 09.02.2012.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

01 Nr _____
Viti, 18 dhjetor 2012



KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Skenderbe Hebibi

Skenderbe Hebibi